

## Një histori e shkurtër e një çmendine, e treguar tepër gabim

### Ayfer Tunç

Në një qytet në Detin e Zi, folësi kryesor, Ylky Birinçiu, po mbante një leksion me titull “Dashuria: Sakrificë apo mbrojtëse e Unit”—ishte 14 shkurt, Dita e Shën Valentinit-- në një sallë me 350 vende në katin kryesor të spitalit psikiatrik që--prandaj edhe ishte ndërtuar me pamje nga deti—i krijonte një ndjenjë të hollë atij që e shihte. Ylky Beu që kishte zgjedhur si titull kryesor një fjali që e kishte huazuar nga Niçja, ishte asistent profesor i psikologjisë dhe punonte në një universitet privat në Stamboll. Ai fliste në tribunë me një stil që e përdorte kur mbante leksione para studentëve, shumica e të cilëve janë shumë të trashë. Përqendrimi i këtij njeriu ishte po aq i çakorduar sa edhe tribuna e mbuluar me Formikën e poshtme, mbi të cilën ai shtyp palmat, shkëmbinjtë e tij sepse një këmbë e ka më të shkurtër se tjetra. Unë nuk mund ta tregoj zeron në fjalën time për shkak të kësaj tribune të keqe! Ai i betohet vetvetes. Në përgjithësi Yky Beut që duhet ta durojë këtë punë, ndonëse nuk para i pëlqen të flalës nëpër tribuna, nuk i pëlqen të tërhiqet, kur është duke folur shumë; tani ai është bërë ploltësisht indifferent ndaj përmbajtjes së leksioneve që jep.

Ai sapo nisi ta përdorte frazën *për zeron në zero*. E kishte zakon të thoshte: jini të përqendruar. Kur vuri re se Profesor Altay Camuri që ishte kthyer në shtëpi pasi kishte kurorëzuar studimet psikoterapeutike duke shkruar një libër voluminoz në Universitetin e Tulsës në ShBA që nuk vlente një grosh, në anglisht, vazhdonte të fliste *nga zero në zero*, ai e përvetësoi menjëherë këtë frazë dhe tani e përdor këtë *nga zeroja në zero*, pavarësisht nga konteksti.

Ylky Beut i pëlqen të përvetësojë shprehje të reja si kjo dhe ka një repertor të pasur; por ai zemërohet me vetveten dhe nuk pranon të përdorë fjalë të rralla. Por dhoma e tij në fakultet ishte në të njëjtin kat me ata të shkencave politike dhe nën ndikimin e së folmes së tyre dilloi të thoshte *konsensus* në vend të marrëveshje e përgjithshme ose miratim universal. Më pas kaloi në katin e juristëve dhe vuri re se fjala konkurrencë tingëllonte shumë më dinjitoze dhe më e këndshme për veshin.

Gjithashtu ka raste kur ai fshin fjalë ose fraza nga repertori i tij duke u shfajësuar se gjoja ato qenkan bërë banale dhe se nuk përdoren me saktësi. Një pasdite vonë, kur dëgjoi sekretaren e fakultetit Shenay Hanëm, aftësia e së cilës ishte vetëm të shkonte me pushime jashtë shtetit me thërrimet e rrogës së saj, duke ia mbajtur të fshehtë nga i shoqi, të thoshte: më japin shumë kënaqësi këto biskota, kjo shprehje i ngjall neveri, shprehja më japin kënaqësi, dhe që atëherë kjo shprehje e mërzit, pavarësisht se kush e përdor.

Megjithatë ai ende nuk ishte në gjendje ta zëvendësonte me diçka tjetër; ai ende ndien mungesën e kësaj shprehjeje të vogël që e ka fshirë e që e ka mbllaçitur sa e sa herë. Në fakt e folura e Shenay Hanëmit, së cilës i pëlqen të rrijë pak si shumë me studentët, të cilët, me anglishten e tyre të kategorisë së tretë kanë mbaruar kolegje të lira, është e pasaktë nga fillimi në fund. Aty ka shumë gabime gjuhësore, kjo grua i bën ato. Por më e keqja është se ajo kujton se kjo është një mënyrë elegante të foluri. Për shembull, nën ndikimin e disa horrave të kolegjit, të cilëve jo vetëm që u pëlqen që kilogramët e saj të tepërt t’i bëjnë objekt gallate midis tyre, por edhe flirtojnë me të për qejf, ajo ka deshifruar fjalën angleze *feel* me turqishten. Asaj i pëlqen aq shumë të pyesë: Si jeni ndier? Si ata. Ylky Beu para ca kohësh

kishte dëgjuar bisedën e saj me një vajzë të mencës. Kur e kishte dëgjuar gruan që po përpiquej të lëvdonte në mënyrë të neveritshme dekanin vetëm për të përfituar prej tij një gotë çaj, *Sa keq u ndjeva për të!*. Miku im më tha se kishte dashur t'ia fuste me një shuplakë surratit.

Natyrisht, ai nuk e qëlloi atë me grusht, nuk shkoi aq larg, por megjithatë bëri një gabim të madh. Në mencën private të universitetit që ishte vërtet një vend tepër i përshtatshëm për të dëgjuar lloj-lloj këllire për një grua, ai në mënyrë tepër të tërthortë tha se studentë me flokë të lyer me xhel simulonin skena seksi në dyert e saj për të përfituar lehtësi burokratike që lidheshin me fakultetin., dhe se këto ishin marrëdhënie interesi personal. Edhe po të kishte qenë vetëm ai që e kishte kuptuar atë që nënkuptohej, ishte njësoj. Më vonë, kur e pyeta se pse e kishte thënë këtë, ai u shpreh se e kishte shtyrë lumturia që rrezatonte kjo grua, ndonëse edhe mund të poshtërohej nga dekani. Shenai Hanëmi i kishte marrë krejt gabim fjalët e Ylky Beut; por, sidoqoftë, s'kishte njeri që do t'i merrte për mirë fyerjet për çështje seksuale. Kur dëgjoji se një burrë kishte thënë koketë ose diçka të përaftërt, mendonte se profesori i asociuar që ishte ndarë nga e shoqja para tre vjetësh e që ishte tashmë mesoburrë, por që, lavdi Zotit, ishte ende shumë i bukur, e vlerësonte, ajo ndihej dy herë e lumtur. Vajzës së mencës që po mbushte kafënë ekspres nga aparati në gota plastike, ajo i tha se ai kishte qenë i vetmi që nuk i kishte bërë komplimente me një buzëqeshje plot krenari. Vajza e mencës gati sa s'qeshi, por u përmbajt sepse s'donte të grindej me këtë grua gjysmë të lajthitur.

Kjo bisedë e pakëndshme pati pasoja jashtëzakonisht negative jo mbi karrierën e Ylky Beut, po për jetën e tij dashurore. Në këtë rreth universitar privat, i cili i zgjeronte shumë kufinj të tij kur vinte puna se kush fle, me kë fle, figura e Ylky Beut, që njihej si njeri që zakonisht mbante lidhje me gra të bukura dhe mundësisht të shkëlqyera, morën një goditje të rëndë. Kështu, ndërsa po përgatitej të merrte si bashkëpunëtor të ri shkencor Selcen Akbashin, që s'kishte shumë kohë që kishte ardhur në sektor e që shumë shpejt u bë i njohur si Selceni bujar, për drekë... ai kishte rezervuar një tavolinë në restorantin më të modës të asaj kohe, që kishte parë Stambolli deri atëherë, me një kënd 360 gradë, ku shërbeheshin vezë, shampanjë e rrallë, lule etj., pasi kishte marrë mijëra puthje nga vajza në *facebook*,-- kështu që ishte i sigurt se çdo vajzë e kishte në xhep, prandaj i kërkoi pastrueses t'i shtronte krevatin me çarçafët më të bukur që a i përdorte vetëm në raste të veçanta. Bukuroshi vajzakërkues shkencor që vazhdon të mendonte "Me kë do të vazhdojë kariera ime e ardhshme për të fjetur", që supozonte se Ylky Beu që shpresonte se do të bëhej një profesor i asociuar i shquar, ishte tashmë një donzhuan që flinte me çdo grua që i qëllonte, e kishte anuluar takimin për atë drekë që ai mezi e kishte pritur prej kaq ditësh me një justifikim jo edhe aq të bazuar.

Pa e zgjatur shume, kur vërejti të qeshurën e shfrenuar të Shenai Hanëmit rreth çështjes së Ylky Beut, ai shkoi menjëherë me këtë femër të hijshme e të bëshme. Ajo vendosi të flinte me Altai Camurin, pasi ishte më i fuqishëm se Ylky Beu në qarqet universitare, ndonëse nuk ishte edhe aq tërheqës sa Ylky Beu. Por nata nuk do të shkonte edhe aq mirë. Ndonëse premtimet e Altai Camurit për ecurinë e karrierës së saj qenë shumë dorëlëshuara, ushqimi që hëngrën në tavernën e zakonshme Beyoglu, që i mërziqshëm dhe ajo që një natë shumë e shkurtër nga pikëpamja seksuale. Selcen Akbashi nuk e dinte se Altai Camuri i kishte thënë së shoqes se *atë natë do të luante poker me grupin, prandaj mos rri zgjuar për mua, shko të flesh, ne do të rrimë gjithë natën*, ajo kishte menduar se sa shumë burra pikërisht kështu u thonë grave pas mësimit për t'u marrë me të dashurat e tyre. Një nga arsyet pse Selcen Akbashi ishte pranuar në rrethin e tyre ishte se ajo asnjë burri që i kishte bërë shenjë se donte të shkonte me të në krevat, nuk i kishte kundërshtuar. Duke besuar se kjo do të ndodhte tashmë gjithnjë, ajo

shkonte të bënte dush, dhe kur dilte, mendonte gjithnjë, *më lini që të jem erotike të paktën më njerin*, dhe vishte kimononë e saj prej mëndafshi që e kishte blerë në Japoni, ndizte një cigare, por duke dëgjuar gërhimën e Camurit që trondiste muret dhe fishkëllimën therrëse që dilte nga hunda e tij, bota e saj bëhej copë e thërrime. Ky njeri as që kishte ndërmend të çohet e të ikte. Atëherë vajza e mjerë mbylli derën e dhomës së gjumit, teshtiu dhe u kthye në dhomën e ndenjies, në kolltuk.

Faktikisht Altai Camuri as që kishte ndërmend ta kalonte gjithë natën në krevatin e Selcenit. Ai kishte planifikuar të shkonte te miqtë e tij të pokerit në një orë të arsyeshme pasi të kishte bërë dashuri me vajzën. Por ai aq ishte lodhur nga mësimdhënia gjatë gjithë ditës, kështu që minutat e stuhishme me Selcanin energjike e kishin këputur fare, peandaj edhe shembur në jastëkun me dantella, nga i cili kundërmontë një aromë tepër e këndëshme. Të nesrëmen ai erdhi në shtëpi, në atë kohë kur e shoqja po përgatiste me ngut mëngjesin, duke dëgjuar historinë e lodhshme se pse ishte munduar aq shumë në poker. Po bëhej gati të bënte një dush dhe të vinte në vete. E shoqja vuri re një shenjë jastëku në faqen e tij, për një çat bëri të grindet me të shoqin, por u kujtua se kishte aq punë, sa që nuk kishte forca për sherr, prandaj u mjaftua duke thënë me vete, se çfarë qelbanikje paska shkuar kësaj radhe.

Psikoterapisti Altai Camur që ishte i sigurt se ishte kthyer në atdhe me një kurorë të padukshme, i shikonte kolegët e tij nga lart. Që kur ishte kthyer nga Amerika, ai nuk para kishte qejf t'i përshëndeste më njerëzit që nuk i quante të denjë nga pikëpamja akademike. Por ai nuk qe në gjendje të bindej për meritat e Ylky Beut që, megjithë vlerësimet, nuk arriti në asnjë mënyrë gradën e profesorit dhe ishte i lëkundur nëse duhej ta përshëndeste edhe atë. Më në fund gjeti një zgjidhje që kërkoi një sforcim e një përvojë të madhe që bënte sikur përshëndeste Ylky Beun, po në fakt përshëndeste personin që ishte pas tij, ose jo njeriun që ishte pas tij po atë vetë, sipas situatës. Cdo herë Ylky Beu i përgjigjej përshëndetjes së Altaj Beut, por atëherë e kaplonte një ndjenjë e pakëndëshme që ky professor vanitoz përshëndeste njeriun pas tij. Altaj Beu që e shkruan mbiemrin e tij si “Camur”, në korespondencën e tij dhe në adresën e tij të postës, këto ditë është i zënë me përkthimin e librit të tij të vetëm në gjuhën e tij amtare, si edhe duke kërkaur një mënyrë të re për të kaluar një natë tjetër me Selcen Akbashin. Por ai di ta administrojë mirë atë, ai ose takohet gjithnjë ose me dekanin ose me zëvendës presidentin gjatë ngrënies, ku u flet atyre më hollësi për mungesë redaktorësh e përkthyesish në vendin tonë. Sa i takon Ylky Beut, me frikë se mos ndokush e mëson se ai ia ka vënë syrin në mëyrë të paligjshme “nga zeroja në zero” nga ky profesori Camur i kurorëzuar në Amerikë, dhe e tall,-dhe kjo nuk afre pa baza, ai kishte dëgjuar me veshët e tij studentët ta tallnin një profesor me nofkën Altaj Zero—prandaj kishte frikë se mos kjo frazë tallëse i vinte padashur në majë të gjuhës, kështu që ai duhej të tregohej i kujdesshëm të mos e përdorte atë në mjediset e tij, po vetmë gjatë udhëtimeve të largëta.

Ylky Birinçiu është një njeri që udhëton shumë edhe pse vetëm brendapërbrenda vendit. Jashtë del shumë rrallë. Herën e fundit, kur e kishin ftuar në një simpozium në Universitetin e Tiranës, ai kishte kërcyer përpjetë nga gëzimi që i ishte dashur të operohej ugjent nga hemorroidet, pasi kështu mund kishte gojë e të thoshte jo. Ndërsa Shenai Hanëmi, nga ana e saj, kishte gjezdisur anekënd botës, nga Dubai e deri në Meksiko, nga Shën Petërburgu, në Venecia. Në çdo udhëtim që bënte, si në rastet kur rrinte tre, apo pesë ditë, asaj nuk i mjaftonin fotografitë që fuste e hiqte nga face *book-u*. Nga merakuri se mos ndokush mund të mbetet pa i kundruar, ajo ua niste me e-mail të gjithëve dhe të gjitha, sidomos ato ku dilte para momumenteve historike.

Ylky Beu mahnitej nga fakti që ajo grua, një e dy ishte gati të nisej e të merrte rrugët e botës. Sikur të kishte qenë e bukur, ai edhe do tyë mund ta kuptonte në ndonjë farë mënyre dhe do të mendonte, se të paktën do kishte ndonjë burrë që e priste diku. Ai nuk e konsideron gruan si dikë që i duhen ngulur sytë. Megjithatë, sa më shumë që mendon se edhe diku, në ndonjë cep të dynjallëkut mund të ekzistojë ndonjë blerës për libidon që shpërhap trupi i saj, prapsepapë nuk do të arrijë deri aty sa të kalojë pushimet me atë grua. Dhe nuk e ka gabim. Lidhjet romantike të Shenay Hanëmit mbarojnë me daljen e diellit.

Nëse ai do të mësonte se për bankën - e cila i kishte dhënë Shenai Hanëmit kredi konsumatori në mënyrë që ajo të mbushte atë çantën e vet të shpinës prej endacakeje me çokollata, kek, sanduiçe me gjalpë dhe sallam që i fshinte nga tryezat e hoteleve ku rrinte dhe pastaj i fuste në qese që t'i hante gjatë ditës, që vishte bluza XXL që nuk ia mbulonin assesi celulitin e këmbëve dhe të gjunjëve të dhjamur dhe bënte fotografi të panumërta- fillimi i procedurave të sekuestrimit ishte vetëm çështje kohe, ai do të ndihej tepër më i lehtësuar që nuk e di as tani.

Ylky Beu është një tip në kokën e të cilit gjen plot gjëra. Është e vërtetë se ai e kupton edhe vetë që pjesa më e madhe e tyre janë kot dhe nuk është aq budalla sa të pandehë se idetë e tij të cekëta mund të kenë kushedi ç'vlerë. Prandaj ka shumë kohë që ai nuk bezdiset me nga kjo. Në fillim, habitej se pikpkamjet e tij të vjetëruara priteshin me entuziazëm gjatë ligjëratave rutinë që ai filloi mbante lart e poshtë sa për të nxjerrë ndonjë lek, pasi nuk ia dilte dot me rrogën e mjerë të universitetit ku punonte, e për më tepër merreshin sikur të ishin ide të reja, por tani është mësuar me to.

Thjesht është mësuar, por nuk është se e admiron edhe aq shumë veten kur idetë e tij të qëmotshme priten me entuziazëm. Ai është i ndërgjegjshëm për gjithçka: për atë se ç'ka qenë, ç'farë është bërë, për atë se ku do të shkojë dhe ç'do të mbetet nga ai në fund të fundit. Megjithatë, edhe sot akoma, këto pritje entuziazte, i japin guximin të mendojë vullshëm dhe të mos ia bëjë syri tërrë që në ligjëratat e veta të hedhë nga ato lloj idesh të cilat nuk kanë pikën e lidhjes. Kjo ndodh sepse, tanimë, askush nuk kërkon që tek gjërat që dëgjon të gjejë ndonjë fije logjike. Edhe nëse e gjejnë, as që e marrin mundimin të kapin fillin e ligjëratave të tij, të bazuara në rrëfime shumëgjyreshe, anekdota të shkurtra dhe të shoqëruara me fotografi të thjeshta të shkarkuara nga interneti, të cilat zgjojnë interes të gjerë. Kësisoj, Ylky Beu, mund të vazhdojë të shkojë nga një qytet në tjetrin e të mbajë konferenca për para. Ylky Beu i duhet të shkojë se s'bën në këto konferenca. Nuk ka tjetër rrugë si të paguajë çdo muaj të bijën, e cila virtualisht është bërë avokatja e të shoqes gjatë këtyre dy viteve të fundit kur papajtueshmëria mes tyre ka arritur kulmin, si edhe të plotësojë tekat e së shoqes, me të cilën u bë pishman që u martua që ditën që firmosën dhe të cilën ka pesëmbëdhjetë vjet që e dëgjon të thotë *eh më duket se jam me barrë, oh nuk është koha e duhur për divorc, oh nuk dua të pësojë gjë karriera ime, dhe që, e rropi gjatë divorcit* Podiumi dridhej fort. Stilolapsi Stabulo u rrotullua ngadalë dhe ra përdhe. Nuk e kishte mbajtur dot veten dhe kishte qëlluar me shkelm mbi podiumin e sajuar. Pak e nga pak ishte bërë i acarueshëm. Gjithsesi, nxehja nuk i vazhdonte gjatë dhe ai dinte se si duhej të ndalej kur tërbimi arrinte kulmin. Herën e fundit që ishte nxehur kishte qenë tre vjet më parë kur kishte kuptuar se nuk bënte dot pa syzet e leximit. Në inat e sipër nuk kishte ndaluar para dritës së kuqe dhe kishte goditur makinën që ndodhej përpara. Edhe pse dukej ashiqare se fajin e kishte krejtësisht vetë, ai qëlloi shoferin e makinës tjetër, i nxiu njërin sy dhe për këtë e çuan në rajonin e policisë. Ja, ky është çmimi i inatit, po mendonte ai ndërkohë që polici e detyroi me pahir që të

puthej e të përqafohej me shoferin me të cilin ai ishte zënë me duart në fyt dhe që kishte ngrënë fasule të thata dhe sallatë qepësh për drekë.

Në fakt, inati i vinte më tepër ngaqë s'kishte ç'ti bënte faktit që po plakej, se sa nga armiqësia kundër syzeve. Arësyeja e frikës nga plakja, buronte më së shumti nga gjërat që nuk kishte arritur dot të bënte, pasi kur vriste mendjen e kishte kuptuar qartë se i kishte kaluar koha e ëndrrave të mëdha, se nuk kishte realizuar asnjë prej tyre, se gjithnjë i kishte shtyrë duke thënë, *do filloj nesër, do ta bëj më vonë, sot, nesër*. Sytë e Ylky Beut, të cilët në të ritë e tij kishin bërë të rrihnin zemrat e të tëra femrave me vështrimin që lëshonin, kishin ngecur akoma tek një grua më pak se tridhjetë vjeçe. Nga ana e tyre, gratë e reja ia hidhnin sytë, por jo se ishte i pashëm e ua bënte zemra bam për të. Me thënë të drejtën, ai, ushtronte ende një tërheqje të fuqishme, por kjo ndodhte vetëm prej karrierës dhe sepse jepte përshtypjen e një njeriu të rëndësishëm. Ndonëse nuk donte t'ia dinte në ishte e vërtetë apo jo, ai ngulmonte të pandehte se ishte i perezistueshëm, njëlloj si edhe në të ri.

Duke qenë se nuk donte t'ia dinte për broshurën e fundit të botuar në lidhje me vitaminat që përmbanin antioksidantë. Sado larg syve ta mbante, ai bindte veten se astigmatizmi i tij ishte i atij lloji që nuk kishte nevojë të mbante syze, fatkeqësisht po rëndohej. Kështu, deshi s'deshi shkoi tek mjeku. Kështu pra, edhe pse pikërisht atë ditë ai e kapi se në realitet po plakej, prapsepër nuk donte ta pranonte.

Ishte tepër i inatosur me oftalmologun Berkaj Yzberk, pasi ky i fundit kishte varur në muret e kabinetit të tij një diplomë të madhe që tregonte se kishte mbaruar studimet të Universitetin e Hasetepesë, - që Ylky Beu e kishte ëndërruar gjatë tërë viteve të shkollës, por ku nuk kishte mundur të vinte dot as këmbën,- dëshmitë e specializimeve të tij dhe fotokopjet e zmadhuara me ngjyra, të *Fakultetit të Mjekësisë në Virginia*, që i thonin, se koha kishte ardhur, madje edhe kishte kaluar, që ai të vinte syzet e leximit.

Edhe pse mjeku i ri në moshë, nuk i ishte shprehur me asnjë formë shpottie pacientit që kishte ardhur të vizitohej për astigmatizëm, ky i fundit mendonte se doktorit nuk do t'i kushtonte gjë, nëse do t'i kishte thënë *se gjendja juaj nuk është shqetësuese, por nuk keni menduar ndonjëherë të vini syze*, në vend që t'i thoshte, *se koha ka ardhur, madje dhe ka kaluar*. Gjithsesi, ai u inatos së tepërmi me këtë mjek të ri, i cili me ato mënyrat e veta të sjellshme, i kishte kujtuar në mënyrë qesëndisëse se po plakej.

Me thënë të drejtën, Berkaj Yzberku, nuk ishte ndër ata njerëz që kanë zakon të acarojnë pacientët. Por kur Ylky Beu, që kishte flokë të dendur e të valëzuar si krifë luani, tëmtha të hirtë ku mezi shquheshin nja dy a tre fije të bardha, pasi pa një poster në mur dhe me një skërmije tek cepat e buzëve përmendi rënien e flokëve duke i shtuar edhe një koment të papërshtatshëm, siç e kishte zakon, në atë çast plasi edhe tensionimi mes tyre.

Në fotografinë e zmadhuar në përmasa gjigande dhe që ishte bërë poster, mjekët e këtij pavjoni elegant, të shtrenjtë dhe të sapohapur të oftalmologjisë, që rastësisht kishin qëlluar të gjithë meshkuj, që me qëndrimet, pamjet dhe vështrimet e tyre ngjanin që të tërë njëri me tjetrin, kishin dalë në rradhë të vendosur përbri e me ca buzëqeshje që iu feksnin dhëmbët. Edhe pse profesori kryesor në ballë të tyre ishte tepër më i vjetër se ta në moshë, që të gjithë qenë të pashëm, energjikë dhe në fytyrën e cilido preh tyre lexohej ashiqare vetbesimi. Gjithsesi, dhe kjo ishte përsëri një rastësi, ata i kishin kokat të rruara. Posterit, i konceptuar

me rradhjeten e kokave të rruara të atyre mjekëve të rinj, flokët e ndokujt mund të ishin thinjur para kohe, ndokujt tjetri mund t'i kishte mbetur ndonjë rrip në mes të tullës dhe që kishin gjetur zgjidhjen që t'i rruanin bidevi, të jepte ndjesinë acaruese të autoritetit dhe të gjakut fisnik.

Ylky Beut, i cili prej ca kohësh e kishte kuptuar paaftësinë dhe mungesat e veta dhe që e mohonte se po plakej, kur pa posterin e atyre mjekëve të rinj që shndërrinin nga vetëbesimi, i erdhi kompleksi i mungesës së flokëve. Vetvetiu, edhe pse me buzëqeshje kaloi dorën nëpër flokët e tij të dendur. Berkaj Yzberku menjëherë e vuri re atë buzëqeshje ironike dhe lëvizjen e tij, çka ia konkretizoi idenë që i kishte shkuar ndërmend.

Nëse Ylky Beu nuk do kishte ndër nevojën që t'i përgjigjej pyetjes mbi syzet, tensioni nuk do ishte rritur, por ai nuk do kishte dashur që të thyhej më dysh nga ai doktor me atë qafë të trashë e muskuloze e që të linte të kuptoje qartë se të paktën tre mëngjeze në javë i kalonte në palestër dhe tha pa e ndjerë nevojën që ta fshihte buzëqeshjen e vet qesëndisëse, *përderisa moda e kokave të rruara ishte përhapur anekënd dheut, nuk mund të kuptoje dot se kush ishte tullac e kush jo*. Mjeku i ri, në familjen e të cilit të gjithë kishin vuajtur nga rënia e flokëve nuk la që ky sulm të kalonte paq. Pa ia kaluar në sarkazëm, ai e bëri të gjorin njeri që të ndiente se rinia e tij kishte shkuar me kohë e me vakt dhe pa ia vënë fare në dukje sikletet që të sjell astigmatizmi, ia vuri gishtin mu te plaga.

Ishte një ekzaminin tejet i tendosur. Ylky Beu, i cili nuk kishte qenë në gjendje të vinte këmbën në SHBA me gjithë përpjekjet që kishte bërë, edhe në kohën kur do kishte dashur të shkonte qoftë edhe për ndonjë program trajnimi tre mujor në Universitetin më kot të atij kontinenti, u acarua nga doktori i ri atletik, nga dhëmbët e shëndoshë, nga dëshmitë në përmasa të ndryshme, e sidomos nga krenaria e pamerituar.

Ylky Beu u rezistoi syzeve të leximit për një kohë të gjatë dhe shkoi madje, edhe tek mjekë të tjerë. Më në fund, përpara se nevoja për t'i vënë t'i bëhej e domosdoshme, ai e kuptoi se kishte firmosur një faturë karte krediti, ku kishte një gabim pa dashje. E mblodhi mendjen dhe zuri të mbante një palë syze të përhershme, por me të cilat shihte mirë vetëm nga afër. Sado e madhe të ishte vëmendja e syve të tij në lidhje me moshën, ai e kuptoi se ato syze shërbenin vetëm për të parë nga afër dhe nuk qenë aspak astigmatike siç pretendonte ai. Megjithatë, besonte, se njerëzit e afërm mendonin që ai ishte akoma i ri dhe se askujt nuk i shkonte ndër mënd se po plakej dhe se përdorte syze leximi. Kur vështrohej në pasqyrë, i hiqte syzet dhe ngaqë nuk shihte dot pranë, nuk arrinte t'i shquante dot ato vijat që quhen rrudha e që u ngjanin brazdave të hapura në dëborë, ndërsa zhubrat që i formoheshin anash buzëve, dukej sikur i ishin qepur në surrat me një pe tepër të hollë. Më e trishtueshmja ishte se këto rrudha shtoheshin me kalimin e kohës, por meqë shikimi i tij rënohej, i dukej sikur ato mbeteshin në vend.

Ai nuk i përgatit kurrë në detaje konferencat që mban kur ia kërkojnë firmat farmaceutike. Ndofta, në të kaluarën, kur ëndrrat e tij qenë akoma të freskëta, ai mund të kishte punuar me ditë të tëra. Tanimë, as që e vriste mendjen dhe mendonte thjesht vetëm për paratë. Ishte më se i bindur se nuk përbënte aspak detyrim për të që t'i përgatisë ligjëratat deri në imtësi, sidomos kur bëhet fjalë për qytetet e vogla të provincës. Për të, del e tepron fakti që është në gjendje të mbajë të ngritur vëmendjen e dëgjuesve. Le që edhe firma farmaceutike, nuk kërkon më tepër se kaq. Për këtë arsye, ai përdor edhe fotografi femrash me këmbë të gjata e gjoks të madh, kokrrat e të cilave nuk duken, çka për provincën është e guximshme, por nuk provokon as konservatorët. Dhe kur ai, me thupër në dorë tregon gjoksin e ndonjë gruaje në

foton që reflektohet tek perdet, studentit që vjen nga shkolla mjeksore nga cepi tjetër i qytetit e që është mësuar me lekisonet e ngurta të mësuesve, po ashtu edhe pacientët e neuropsikiatrisë, të cilët, teksa presin rradhën e vizitave e që kanë zbuluar se salla e konferencës është ideale për t'ia marrë një sy gjumë, çakërrejnë sytë. Ylky Beu, e di se mënyra më e mirë për të ngjallur interesin e vdekur të audiencës, kalon përmes seksit dhe e përdor mjeshtërisht këtë marifet.

Podiumi me një këmbë më të shkurtër se të tjerat gjendet në sallën e konferencave të spitalit psikiatrik me një kat të lartë në qytetin e Detit të Zi, është vendosur në të djathtë të skenës në mënyrë që të qëndrojë një çikë anash. Kësisoj, ai mund ta shohë lirisht si publikun, ashtu edhe perdet e bardha që mbulojnë tej e tej muret e zinj. Portierit, Zija shurdhi, që është edhe përgjegjësi i pastrimit dhe i mirëmbajtjes së sallës, s'para ia ka ënda t'i hapë, sa herë që fillon apo mbaron konferenca.

Perdet janë tepë të rëndësishme për Ylky Birinçiu. Kjo ndodh sepse ligjëratat që ai thotë se i shkruan në formë pikash me qëllim për t'i reduktuar në thjeshtësi absolute dhe me një dozë humori, si edhe fotografitë që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me temën, reflektohen në ato perde përmes poëer point-it. Ai e ka zakon të përdorë sa më shumë shenja klishe në paragrafët që i paraprijnë artikullit Gjithashtu, atij i pëlqente tu dërgonte njerëzve nga to vizatimet e gatshme me buzëqeshje, rrahje qepallash dhe puthje, dhe të përdorte pseudonime kuptimplotë atyre njerëzve për të cilët nuk ishte i sigurtë se cilit seks i përkisnin e me të cilët ai lidhej nëpër biseda chat-i, ku nuk harronte të përdorte disa shprehje teje erotike të cilat e ngacmonin jashtëzakonisht. Ai i kishte përsosur tejmase shprehitë në gjuhën e chat-it. Ishte anëtar i shumë grupeve të çuditshme në internet. Këta miq të chateve me pseudonime erotikë tej çdo përfytyrimi, natyrisht i dërgojnë fotografi fallco dhe një e dy shkruajnë *le të takoheni më mirë prej vërteti*.

Qysh kur ishte ndarë nga e shoqja, ai u kishte thënë po, të paktën dy prej këtyre propozimeve. Edhe pse për një fije gjë, e kishte humbur Elsen Akbashin, tani interesi për gratë që kishte rreth vetes nuk i ishte pakësuar aspak. Ai nuk kishte nevojë për ato shkronjat seksuale të botës misterioze të internetit. Megjithatë, interesi për gratë që njihte, nuk ishte i mjaftueshëm që t'ia qetonte fantazinë e xhindosur që i kishte hyrë në thellësi të vetes, e që as ai vetë nuk e dinte se kur kishte ndodhur. Edhe pse ky djall i cili e përndizte sa herë që ulej përballë ekranit nuk e tundonte konkretisht, gjithnjë e më shumë ai bënte më pak drejt realitetit dhe parapëlqente këta njerëz me të cilët bisedonte pa pushim për orë të tëra gjatë natës, i mahnitur nga fuqia e tij e përfytyrimit, e nga mbyllja në botën virtuale.

Në botën virtuale ai kishte zgjedhur fjalën *Zebb* si pseudonim. Për Ylky Beun nuk ishte kushedi se me ç'fantazi, por i jepte mundësinë që gjatë natës, kur drithërohej në vetminë që e ngërthente dhe brenda së cilës ai arratisej larg nga ekzistenca e tij e përhumbesh në thellësitë e dëshirave të shtypura, të hynte e të bisedonte me orë të tëra. Ndonjëherë, gjatë ditës dhe sidomos kur ishte me njerëz seriozë, i kujtoheshin të pabërat e natës dhe duke menduar se turpi që ndiente nga bisedat erotike që kishte bërë në chat mund t'i lexohej në fytyrë, dridhej i tëri.

Ai ka frikë.

Është i tmerruar nga prirja se nuk është i zoti t'i ndrydhë dëshirat mu tek vendi ku ato burojnë dhe se nuk është në gjendje të kthehet përsëri në qënien e tij reale, në identitetin e tij serioz prej akademiku punëdashës. Nëse do të takohej në botën reale- të cilën ata e quajnë *prej*

*vërteti*- ballë për ballë me miqtë profesionalë të chatit të cilët i dërgojnë foto që s'janë tyret dhe identitetin e të cilëve ai madje as që e merr me mend, nuk e di se si do të reagojnë

Përveç podiumit që lëkundet ka dhe një altoparlant të pluhurosur, stema e nxirë nga koha e gjatë e spitalit që i kthen tërësisht kurrizin detit, posteri i përkohshëm prej bezeje i firmës lokale sponsorizuese e cila nuk ka asnjë vlerë sociale për asnjë institucion dhe flamuri turk që varet për çdo festë zyrtare pa u larë ndonëherë, është krejt e kundërta asaj që të zënë sytë, pasi hap derën e hyn brenda. Parketin që po kalbet, e kanë mbuluar me një linoleum të dobët me një dizajno si gjoja prej parketi të vërtetë.

Nga plasaritja, cepat, madje, kanë filluar të çajnë linoleumin dhe dyshemeja po mbushet me gunga të vogla. Mirëmbajtësi Zija Shurdhi, s' dëgjon për qamet ta pastrojë atë linoleum, i cili është shtruar me urdhër të Shefit të Shërbimeve Mjekësore Demir Demirit, kur ky i fundit i ra në të se do të kishte qenë tepër e kushtueshme që të zëvendësonin krejt parketin. Kjo ndodhi sepse uji me detergjent mbi linoleum nuk thahet kurrësesi, pasi Zija Shurdhi kujtohet ta lajë vetëm pesë muinuta përpara fillimit të konferencës. Për këtë arsye, jo rrallëherë, Shefi i Shërbimeve Mjekësore dhe ligjërues të rëndësishëm, mend janë rrëzuar. Madje, Kreu u Bashkisë Taçetin Bashusta dhe Zëvendës Guvernatori Hikmet Keleshogly, të cilët ishin vënë në garë se kush do e i merrte nën hyqëm konferencat, qysh kur televizioni lokal kishte nisur të rregjistronte të gjitha veprimtaritë, për pak sa nuk kishin rrëshkitur, por ka patur plot të tjerë që kanë janë plasur mbi dyshme

Një prej këtyre ligjëruesve të rëndësishëm ishte edhe Erdem Bakırçiogly, shok i konviktiti të shkollës së Shefit të Shërbimeve Mjekësore. Gjatë viteve kur kishin studiuar në Litseun e Gallatasarait ata flinin në shtrate marinari, njëri poshtë e tjetri lart në të njëjtën dhomë dhe gjatë natës, këmbeshin, njëri zbriste poshtë dhe tjetri ngjitej lart.

Nëse Shefi i Shërbimeve Mjekësore Demir Demiri, fliste për këtë problem prej vitesh, kësaj rradhe ai nuk mund i vinte dot në ndihmë, as ajo shprehja e tij standarte që *njeriu nuk mund të shkojë në Bejuglu pa kapele*. Gjithsekush në atë qytet qindra kilometra larg Stambollit që kishte dëgjuar kujtimet e rinisë së Shefit të Shërbimeve, e kishte mësuar tashmë se në ato vite, nuk mund të shkohej në Bejuglu pa kapele dhe se njerëzit e rëndësishëm që kishin drejtuar jetën kulturore dhe artistike gjatë asaj periudhe zhvillonin biseda mbi artin në dy ëmbëltores: Lybion dhe Markiz, njëra më e famshme se tjetra dhe për më tepër, një herë, Shefi i Shërbimeve Mjekësore dhe shoku i tij i dhomës së konviktit i kishin shtrënguar dorën vetë Jaha Qemalit dhe se po në të njëjtën ditë kishin parë Sait Faikun tek dilte nga Kinemaja Ekhamra. Dinin po ashtu edhe se Ajhan Ishin-i, të cilin një ditë ata e kishin ndjekur këmba këmbës kur ecte rrugës, ishte vërtet një njeri i sjellshëm, por ky infirmacion nuk kishte pikën e kuptimit për askënd në atë qytet.

Puna nuk ishte se Demir Beu sajonte, por vetëm se zbulonte pakëz. E vërteta është se ai kishte arritur ta shihte Ajhan Ishikun, por vetëm nga një farë largësie. Gjithsesi, gjatë viteve kur kishte qenë student në Gallatasaraj, ai nuk e kishte idenë se ç' vend zinin në historinë e letërsisë Sait Faiku apo Jaha Qemali, madje vinte edhe në dyshim se nga u vinte tërë ajo famë atyre dy burrave. Shefi i Shërbimeve mjekësore, i cili pandehte se ata kishin rrojtur deri vonë, shkollën filllore e kishte bërë në Antakia- që ai e quante Anteke- gjatë viteve kur Sait Faiku dhe Jaha Qemali kishin bërë emër në Bejuglu

Erdem Beu, shoku i dhomës së konviktiti të Shefit të Shërbimeve Mjekësore, ishte një burokrat në pension, i cili kishte qenë Drejtor i Përgjithshëm i TCDD, Hekurrudhat e Shtetit

të Turqisë, për shumë vite. Ai ishte ftuar nga vetë Shefi i Shërbimeve Mjekësore të fliste për një temë krejtësisht absurde si *Udhëtimet me Tren dhe Shëndeti Mendor*. Demir Beu nuk e kishte vrarë shumë mendjen nëse udhëtimi me tren mund të qe i dobishëm për shëndetin mendor, por, gjithsesi, atij vetë i kishte shkuar ndër mend t'ia propozonte këtë temë mikut të tij. Kjo për arësyen sepse ai donte të bënte një gjest të lartë kundrejt shokut besnik të dhomës së konviktit, i cili nuk e kishte harruar kurrë, por çdo vit i dërgonte nga një kartolinë, i telefononte shesh dhe e pyeste si ishte me shëndet dhe nuk harronte t'i thoshte se nëse i binte rruga nga Stambolli, do ta priste krahëhapur, dhe i kujtonte ditët e e shkuara me vargjet: *Ato ishin ditë, miku im i dashur, kur nuk mund të shkoje në Bejuglu pa kapele*. Shpenzimet i kishte mbuluar me fondet e lëvizshme të spitalit. Prandaj, për një njeri që kishte punuar tek hekurrudhat, për një konferencë në që mbahej në një sapital psikiatrik, nuk mundi të gjente tjetër temë, veç kësaj.

Edhe për fondet e lëvizshme të spitalit, Shefi i Shërbimeve Mjekësore Demir Demiri, kishte nga luante. Në qoftë se do ta kishte ftuar mikun e tij në shtëpi, e shoqja, Sevim Demiri, do ishte hedhur përpjjetë, pasi nuk donte mysafirë. Sevim Hanëmi, e cila ishte martuar më Demir Beun kush kur kishte qenë nxënëse në kolegjin e infermiereve dhe që e kishte lënë zanatin pa e filluar akoma, vuante nga çrregullime obsesivo-kompulsive të personalitetit. Në shtëpi, ngaqë nuk ndihej rehat, në qoftë se nuk pastronte çdo gjë që ishte prekur nga të huajt, me një lëng që ajo e quante ujë ozonik. Ajo ishte nga Ankaraja dhe kur nuk honepste dot njerëzit që i vinin për vizitë, merre me mend sa mund të duronte ata që mund t'i bujtnin edhe për të fjetur.

...

Translated by:

**Rexhep Hida**

[fannoli2002@yahoo.com](mailto:fannoli2002@yahoo.com)

**Ayfer Tunç** official web site:

[www.ayfertunc.com](http://www.ayfertunc.com)

Ayfer Tunç's New Novel

The Very ERRONEOUSLY NARRATED Short History Of A Madhouse

Web site of the book:

[www.birdelilerevininyalanyanlisanlatilankisatarihi.com](http://www.birdelilerevininyalanyanlisanlatilankisatarihi.com)

Contact (copyright)

**Kalem Agency**

Tünel Ensiz Sok. no: 2/3 34430 Beyoglu İstanbul Turkey

Tel: +90 212 245 44 06

Fax: +90 212 245 44 19

[info@kalemagency.com](mailto:info@kalemagency.com)

[nerminmollaoglu@gmail.com](mailto:nerminmollaoglu@gmail.com)

[www.kalemagency.com](http://www.kalemagency.com)